

PROJEKT - VENDIM

Nr. ___ Date 19.06 2018
5512

**PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN E KESHILLIT BASHKIAK NR.11,
DATE 29.01.2018 "PER MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE
VENDORE PER VITIN 2018" DHE NE VENDIMIN E KESHILLIT BASHKIAK NR.52 ,
DT.25.04.2018.**

Ne mbështetje te ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.9920, dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i propozoj Keshillit te Bashkise Lezhë miratimin e ndryshimeve në nivelin e Taksave dhe Tarifave si më poshtë:

I. Në kapitullin II ,në tabelën 12 "*Tarifa për zënien e hapësirave publike*".

Në pikën 1, sipas VKB nr.52, dt.25.04.2018 , tarifa për zënie hapësire publike për qellime biznesi, vendosje mallrash apo tavolinash, tezgash, vazosh, et., është 1000 Leke/m²/muaj, propozoj të bëhet 500 Lek/m²/muaj.

Ne rastin e subjekteve qe ushtrojne aktivitet ne trajten e tendave apo vendosje tavolinash në sipërfaqe private, të cilat janë jashtë sipërfaqes së ndërtimit, në këto raste të aplikohet tarifa fikse 200 lek/m²/vit. E njëjta tarife të aplikohet edhe në rastin e vendosjes së shezllongjeve në hapësira rëre që janë pronë private.

II. Në kapitullin II. "*Tarifat e shërbimeve publike*"

Pika II.9 "Tregtaret ambulante"

Te behet nje specifikim për "Tregtaret Ambulante" që operojne ne shëtitoren "Willson"- Shengjin. Kjo tarifë per keta tregtare te behet 15,000 leke/vit (sezon).

Kurse per tregaret e tjere ambulante që ushtrojnë aktivitet në vende të tjera kjo tarifë të mbetet 2,000 leke vit.

III. *Pika II.6 Tarifa e dhënies se lejeve per motorat e ujit*

Te shtohet nje pike per motorat e ujit dhe të aplikohet tarifa 50,000 lekë/mjet/sezon.

IV. Në "kreun 1.2 "Taksa mbi pasurine e paluajtshme"

Pika I.1 Ndertese per qellime banimi

Sipas VKM nr.132,date 07.03.2018 ,taksa mbi ndertesën për qellime banimi do te bazohet mbi çmimin referues te banesave,sipas tabelës ne aneksin nr.1 te ketij VKM. Per qytetet Lezhe dhe Shengjin taksa e banesës për qëllime banimi në VKB nr.52,dt.25.04.2018 është vendosur që kjo takes të jetë **28leke/m²/vit**.Ndersa për njësitë e tjera administrative kjo takes te jete **20 Lek/m²/vit**.

I propozoj Këshillit Bashkiak që taksa e ndertesës per qellime banimi ne zonat qe kane kontrate me Ndermarrjen Ujesjelle-Kanalizime ShA,kjo takse te perfshihet ne faturen e ujit te pijshem per te gjithë klientet,duke perjashtuar ato qe me ligj perjashtohen nga pagesa e kesaj takse.

Per qytetin e Shengjinit taksa do te perfshihet me nje kest te vetem,duke aplikuar taksen 28 lek/m²/vit.

Per qytetin e Lezhes dhe njesite e tjera te shperndahet ne 5 keste te barabarta ,sipas siperfaqes se banimit perkates.

Për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujesjelles-Kanalizime SHA,pagesa të kryhet pranë Njësive Administrative perkatese.

KRYETARI
Fran FRROKAJ

